



Titulli i projektit

Përmirësimi i shërbimit ambulator

Tipi i projektit

Shërbime Publike

Vendndodhja e projektit

ZF Shijak (4 NJQV)

Buxheti i paravlerësuar

343,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Nga analiza studimore e Zonës Funksionale Shijak, rezultun se NJQV e zonës nuk i kryejnë shërbimet spitalore në spitalin e Shijakut, ndër të tjera edhe për mungesë pothuajse totale të shërbimit ambulator dhe personelit të specializuar për të ofruar shërbimin. Mjetet në dispozicion të spitalit Shijak ose janë jashtë funksionit, ose tepër të amortizuara për t'u vënë në shërbim të komunitetit. Si rrjedhojë ky transport kryhet rëndom me mjete të rastit. Në këtë situatë dhe duke marrë në konsideratë që 4 NJQV tashmë do të bëjnë pjesë në një njësi të vetme, lind nevoja e pajisjes së spitalit Shijak, si institucioni në ngarkim të të cilit është e gjithë popullsia e zonës, me mjetet e përshtatshme për transportin e pacientëve: 5 ambulanca.

Qëllimi/et specifik të projektit

Nëpërmjet këtij projekti arrihet të përmirësohet shërbimi shëndetësor dhe në veçanti ai ambulatori Zonës Funksionale Shijak.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Të gjitha NJQV (4 të tilla) e Zonës Funksionale Shijak përfitojnë në mënyrë të barabartë nga zbatimi i këtij projekti. I gjithë komuniteti banues i Zonës Funksionale Shijak (27861 banorë) është përfitues i këtij projekti. Në mënyrë të veçantë, spitali dhe shërbimi ambulator i tij përmirësojnë shërbimin e tyre kundrejt pacientëve në të gjithë territorin e Zonës Funksionale, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimeve ndaj popullsisë lokale.

# PROJEKTI 4



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

- Tenderimi dhe blerja e 5 ambulancave për qendrën shëndetësore në Zonën Funksionale Shijak;
- Trajnimi i personelit përkatës.

## Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimin e këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor dhe qendrën shëndetësore Shijak.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë pamundësitë financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohej financim nga donatorët e huaj dhe fondet e zhvillimit të rajoneve të Qeverisë Shqiptare. Njësia e prokurimit pranë Ministrisë së Shëndetësisë është struktura e duhur për zbatimin e këtij projekti.

## Kostot e projektit

Tenderimi dhe blerja e 5 ambulancave për spitalin Shijak  
Trajnimi i stafit përkatës

300,000  
43,000